


RAPORT

MONITORIMI PËR ZBATIMIN E LIGJIT PËR
PJESËMARRJE RINORE DHE POLITIKA RINORE



Këshilli Rinor Nacional
i Maqedonisë

BOTUES:

Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë
Rr. Veljko Vlahovi nr. 7 / 1-1, 1000 Shkup
www.nms.org.mk
info@nms.org.mk

RRETH BOTUESIT:

Marija Krstevska, kryetare

AUTOR:

Filip Kulakov

REDAKTOR:

Filip Kulakov

BASHKËPUNUESIT:

Mariana Angelova, Kristijan Panev, Marija Basheska, Aleksandar Todorovski,
Gjorgji Nançev, Zoran Ivanov, Ivana Haxhi-Nikollova Kalinova, Metin
Muaremi, Sllavica Jovçeska dhe Tamara Petkovska

TITULLI I ORIGINALIT:

Мониторинг-извештај на имплементацијата за Законот за младинско
учество и младински политики

LEKTOROI:

Valentina Joshevska

PËRKTHIM NGA GJUHA MAQEDONASE:

Vjosa Taipi

DIZAJN:

Ilija Stankovski

PRINTIMI:

Stradun D.O.O.E.L.

TIRAZH:

30 ekzemplarë

VITI I BOTIMIT:

2022

PËR KRNМ

Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë (KRNМ) është një platformë që përfaqëson interesat dhe nevojat e të rinjve si lidhje ndërmjet të gjitha palëve të interesuara dhe siguron përfshirjen dhe pjesëmarrjen aktive të të rinjve në procesin e vendimmarrjes në çdo nivel. KRNМ është themeluar më 29 qershor 2013 nga 55 organizata.

KRNМ është organ përfaqësues i organizatave rinore në Maqedoninë e Veriut. Këshilli bashkon aleanca, organizata rinore, organizata rinore dhe forume rinore të organizatave të tjera me qëllim të promovohen dhe përfaqësohen të rinjtë dhe të drejtat e të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Anëtarësia e KRNМ-së është e larmishme, duke bashkuar organizata që veprojnë në nivel kombëtar dhe rajonal, në zonat rurale dhe urbane, organizata studentore, degë të organizatave ndërkombëtare dhe lloje të tjera shoqatash. Në procesin e arritjes së qëllimeve të tyre, KRNМ përfaqëson interesat e të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut pavarësisht nga statusi i tyre socio-ekonomik, gjinia, raca, prejardhja etnike dhe kulturore, bindjet politike dhe fetare, orientimi seksual, identiteti gjinor apo çdo formë tjetër.



PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	7
LIGJI PËR PJESËMARRJE RINORE DHE POLITIKA RINORE	9
METODOLOGJIA	12
PJESËMARRJA RINORE	14
<i>ASAMBLEJA KOMBËTARE RINORE</i>	15
<i>ORGAN KËSHILLIMOR KOMBËTAR PËR POLITIKA RINORE</i>	16
<i>KËSHILLA RINORE LOKALE</i>	16
POLITIKA PËR TË RINJTË	20
<i>STRATEGJIA KOMBËTARE PËR TË RINJTË</i>	21
<i>STRATEGJI LOKALE PËR TË RINJ</i>	22

PËRMBAJTJA

SHËRBIMET RINORE	24
<i>ZYRA RINORE</i>	25
<i>QENDRA RINORE</i>	26
<i>NËPUNËSIT RINOR</i>	27
<i>QENDRA KËRKIMORE NË LIDHJE ME TEMA QË KANË TË BËJNË ME TË RINJTË NË AGJENCINË PËR RINI DHE SPORT</i>	28
FINANCIMI	29
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	32
SHTOJCAT	38
<i>PYETJE TË CILAT I DËRGUAN NË KOMUNAT</i>	39
<i>PYETJE TË DËRGUARA PËR AGJENCINË PËR RINI DHE SPORT</i>	40

7 | PARATHËNIE

Më 14 janar 2020, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi Ligjin për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore. Periudha para miratimit, shënon një sektor rinor aktiv, i cili në dialog dhe bashkëpunim me palët relevante të interesit dhe partnerët ndërkombëtarë në Maqedoninë e Veriut, ia doli përmes konsensusit nga të gjithë aktorët politikë, të sigurojë një kornizë ligjore për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikatat rinore.

Megjithatë, përkaj miratimit të tij dhe afatet e theksuara ligjore për detyrimet e shtetit ndaj të rinjve, zbatimi i ligjit është ende në nivel të ulët.

Periudha dyvjeçare pas miratimit të Ligjit është shënuar me kriza shëndetësore, ekonomike dhe politike, të cilat janë shfrytëzuar rregullisht si arsye për zvarritjen e zbatimit të dispozitave të ligjit. Të rinjtë këtë periudhë mbetën vetëm prioritet në premtimet zgjedhore, ndërsa moszbatimi i Ligjit vetëm sa forcon qëndrimin e të rinjve se ata janë poshtë në agjendat e vendimmarrësve.

Bazuar në një anketë të kryer nga KRNМ, në vitin 2019, 13% e të anketuarve besojnë se nuk dëgjohen nga vendimmarrësit¹, ndërsa me këtë praktikë të shtetit do të jetë më e vështirë të ndryshohet ky qëndrim i të rinjve.

Në një mënyrë ky raport monitorimi do të përpiqet të japë përgjigje në lidhje me atë se në çfarë përmasa implementohen mundësitë dhe mekanizmat të cilat i kanë të rinjtë që të ndikojnë në proceset e krijimit të politikave dhe miratimit të vendimeve të parashikuara me Ligjin, por edhe nga aspekti i implementimit të Ligjit, sa lartë janë të rinjtë në agjendën e politikanëve.

Raporti i monitorimit për zbatimin e Ligjit për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore është realizuar me mbështetjen e Projektit të USAID-it për Pjesëmarrje Qytetare përmes aktivitetit Laboratorët Rinor për Politika, përmes të cilit të dhënat janë mbledhur në nivel lokal nga Zyrat Rajonale të KRNМ-së.

1. Cross-Sectoral Youth Assessment – North Macedonia, July 2019 (I qasshëm në: https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PA00WB77.pdf)

Falemënderim të madh për zyrat tona rajonale, gjegjësisht Qendrën për Dialog Ndërkulturor (Rajoni Verilindor), Fondacioni për Zhvillim të Bashkësisë Lokale - Shtip (Rajoni Lindor), Shoqata AQUA - Strugë (Rajoni Jugperëndimor), Qendrën Kulturore Rinore - Manastir (Rajoni i Pellagonisë), Qendrën Rajonale për Zhvillim të Qëndrueshëm - Gjevgjeli (Rajoni Juglindor), Këshillin për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve - KPDM (Rajoni i Vardarit) dhe Qendra për Arsimit dhe Zhvillim (Rajoni i Pollogut).

LIGJI PËR PJESËMARRJE RINORE DHE POLITIKA RINORE

Në vitin 2018, me iniciativë të Klubit për çështje dhe politika rinore në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, filloi procesi për krijimin e Ligjit për të rinjtë. Prosesi vazhdoi për herë të dytë, pasi në vitin 2011 nga shteti, me kërkesë të sektorit të rinisë, propozim - ligji i atëhershëm për të rinjtë u tërhoq.

Në nivel kombëtar, gjatë procesit të krijimit të ligjit, u formua një grup pune ekspertësh i përbërë nga përfaqësues të sektorit të të rinjve, me qëllim që të kontribuojë në krijimin e përmbajtjes së ligjit, bazuar në përvojat e tyre të punës me të rinjtë në nivel kombëtar dhe lokal. Grupi punues i ekspertëve përfshinte deputetë të pozitës dhe opozitës, përfaqësues të forumeve rinore të partive politike dhe përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare. Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë mori pjesë me pesë përfaqësues, të cilët përfaqësonin interesat e organizatave anëtare të Këshillit. Gjatë këtij procesi, Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë me mbështetjen e organizatave të tij anëtare dhe Bazës së trajnerëve të KRNМ-së, realizoi 17 konsultime me të rinjtë në nivel lokal me qëllim të përcaktimit të nevojave të të rinjve për atë që ata dëshirojnë të zbatohet me Ligjin e ri për të rinjtë. Më 14 janar 2020, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi Ligjin me titull “Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore”.

Ligji për pjesëmarrjen rinore dhe politika rinore është zgjidhja e parë ligjore në Maqedoninë e Veriut që garanton pjesëmarrjen e të rinjve dhe njeh të rinjtë dhe format e organizimit të të rinjve. Si i tillë, Ligji bën dallimin ndërmjet një organizate rinore, një organizate për të rinjtë dhe një organizate ombrellë rinore, dhe delegon detyrimin e Agjencisë për Rini dhe Sport për të mbajtur një Regjistër të formave të organizimit rinor. Ligji gjithashtu për herë të parë përcakton se çfarë është person i ri, politika rinore, pjesëmarrje rinore, punë rinore dhe punëtor rinor. Për sa i përket pjesëmarrjes rinore, ligji parashikon mekanizma në nivel kombëtar dhe lokal për përfshirjen e të rinjve në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes, përkatësisht Trupin Këshillimor Kombëtar për Politika Rinore dhe këshillat rinore lokale në të gjitha komunat.

Nga aspekti i politikave rinore, në vetë Ligjin është përfshirë miratimi i strategjisë kombëtare për të rinjtë dhe strategjitë lokale rinore, si dokumente strategjike kryesore për aktivitetet rinore të cilat i planifikojnë dhe zbatojnë institucionet dhe komunat. Strategjia Kombëtare për të rinjtë është një dokument strategjik që përcakton synimet dhe prioritetet afatmesme për zhvillimin e politikave rinore dhe promovimin e interesave të të rinjve dhe miratohet brenda një periudhe pesëvjeçare. Strategjia Lokale për të rinjtë është një dokument strategjik i cili, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për të rinjtë, përcakton synimet dhe prioritetet afatmesme për zhvillimin e politikave rinore dhe promovimin e interesave të të rinjve në nivel lokal.

Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore parasheh edhe shërbime rinore, gjegjësisht mekanizma për afrimin e institucioneve për të rinjtë dhe mundësimin e rritjes dhe zhvillimit të tyre. Si të tillë, në kuadër të Ligjit janë përkufizuar zyrat për qendrat rinore, ndërsa në kuadër të institucioneve shtetërore dhe komunave është paraparë që të caktohet nëpunës për të rinjtë, përkatësisht një person përgjegjës për funksionimin e zyrës rinore të lartpërmendur, si dhe për koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e çështjeve me interes për të rinjtë në fushëveprimin e kompetencave të institucionit. Në kuadër të kapitullit Shërbimet për të rinjtë, Agjencia për Rini dhe Sport pritet gjithashtu të krijojë qendra kërkimore për tema të lidhura me rininë.

Përfundimisht, sa i përket financimit për zbatimin e këtij ligji, nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut ndahen çdo vit mjete në vlerë prej së paku 0,3%, ndërsa nga buxhetet e komunave për të rinjtë ndahen mjete në shumën prej të paktën 0,1% në vit.

Ligji për pjesëmarrjen rinore dhe politika rinore, në formën në të cilën është miratuar, mbulon shumë përfitime për rininë dhe organizatat rinore në Maqedoninë e Veriut, por lë hapësirë për zgjerimin dhe promovimin e tij, veçanërisht në drejtim të krijimit të mekanizmave për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit në nivel qendror dhe komunal dhe sigurimin e cilësisë së mekanizmave të parashikuar për pjesëmarrjen rinore dhe shërbimet rinore, si dhe për njohjen e KRNМ-së, si Këshill Rinor Nacional, që është praktikë në vendet evropiane, me qëllim shfrytëzimin e kapaciteteve dhe praktikave ekzistuese të krijuara përmes KRNМ-së për të krijuar politika rinore më të mira dhe cilësore.

11 | METODOLOGJIA

Objekt i monitorimit të këtij raporti është zbatimi i Ligjit për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore. Me qëllim përcaktimin se sa nga obligimet ligjore janë zbatuar, Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë ka krijuar metodologji të bazuar në kërkesat për qasje në informacione me karakter publik nga aktorë përgjegjës në nivel lokal dhe kombëtar. Bazuar në të dhënat e siguruar nga monitorimi i kryer mbi institucionet qendrore dhe komunat përgjegjëse për zbatimin e ligjit, u arrit të përcaktohet shkalla e zbatimit të shërbimeve rinore dhe mekanizmave për pjesëmarrjen rinore.

Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë ka monitoruar institucionet qendrore përgjegjëse për zbatimin e Ligjit, së bashku me komunat nga rajoni planor i Shkupit, ndërsa monitorimin e komunave në rajonet tjera e kanë bërë zyrat rajonale të KRNМ-së, gjegjësisht Qendra për Dialog Ndërkulturor (Rajoni Verilindor), Fondacioni për Zhvillimin e Bashkësisë Lokale - Shtip (Rajoni Lindor), Shoqata AQUA - Strugë (Rajoni Jugperëndimor), Qendra Kulturore Rinore - Manastir (Rajoni i Pellagonisë), Qendra Rajonale për Zhvillim të Qëndrueshëm - Gjevgjeli (Rajoni Juglindor) Këshilli për parandalimin e delikuencës së të miturve - (Rajoni i Vardarit) dhe Qendra për Edukim dhe Zhvillim (Rajoni i Pollogut). Pyetjet e bëra nga komunat dhe institucionet qendrore synonin të përcaktonin nëse shërbimet rinore dhe mekanizmat për pjesëmarrjen e të rinjve janë zbatuar, nëse është ndjekur procedura për përcaktimin e tyre, së bashku me afatin e përcaktuar ligjor dhe nëse është planifikuar buxhet për të rinjtë.

Duke qenë se të dhënat janë mbledhur në periudhën shtator - dhjetor 2021, KRNМ ka bërë të gjitha përpjekjet, por nuk mund të garantojë saktësinë dhe plotësinë e informacionit që përmban raporti i monitorimit apo të eliminojë mundësinë e anomalive duke qenë se në periudhën e përpunimit të të dhënave ekziston mundësia që situata për çështje të caktuara të ketë ndryshuar.

PJESËMARRJA
RINORE

Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore e përkufizon termin "pjesëmarrja rinore" si një proces që u mundëson të rinjve të marrin pjesë dhe të marrin së bashku vendime dhe programe politike që formësojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi jetën e të rinjve.²

Në kuadër të vetë Ligjit parashikohen mekanizma për pjesëmarrjen e të rinjve në nivel nacional, përkatësisht Asamblenë Kombëtare Rinore; dhe në nivel lokal, gjegjësisht Këshillat Rinor Lokal.

Për sa i përket zbatimit, Asambleja Kombëtare Rinore dhe rrjedhimisht Trupi Kombëtar Këshillimor për Politika Rinore ende nuk janë themeluar ndërsa Këshillat Rinor Lokal ekzistojnë vetëm në 11 komuna (13.5% e numrit të përgjithshëm të komunave).

ASAMBLEJA KOMBËTARE RINORE

Asambleja Kombëtare Rinore është një organ i formave të organizimit rinor që zgjedh përfaqësuesit e të rinjve në Trupin Kombëtar Këshillues për Politika Rinore, krijon prioritete dhe politika për përfaqësimin e përfaqësuesve të të rinjve dhe koordinon dhe monitoron punën e tyre.³

Asambleja Kombëtare Rinore mbledh bord iniciativ prej të paktën dy të tretat e formave të organizimit rinor nga Regjistri i Agjencisë për të Rinj dhe Sport. Në momentin e përpunimit të të dhënave nga monitorimi i kryer, pra në bazë të të dhënave të publikuara nga Agjencia për Rini dhe Sport deri në fund të vitit 2021, Regjistri numëron gjithsej 63 organizata, nga të cilat 10 janë organizata rinore, 50 organizata për të rinjtë dhe 3 organizata ombrellë.⁴

Që nga miratimi i ligjit, Asambleja Kombëtare Rinore ende nuk është formuar.

ORGAN KËSHILLIMOR KOMBËTAR PËR POLITIKA RINORE

Trupi Këshillimor Kombëtar për Politika Rinore paraqet një mekanizëm bashkëpunimi ndërmjet përfaqësuesve të sektorit të rinisë dhe përfaqësuesve të organeve të administratës shtetërore që

2. Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore ("Gazeta zyrtare e RMV", nr. 10/2020)

3. Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore ("Gazeta zyrtare e RMV", nr. 10/2020)

4. Regjistri i organizatave rinore dhe organizatave ombrellë të Agjencisë për Rini dhe Sport (publikuar më 15.12.2021), i qasëshëm në:

<http://ams.gov.mk/wp-content/uploads/2021/12/РЕГИСТАР-НА-МЛАДИНСКИ-И-ЧАДОР-ОРГАНИЗАЦИИ-update-15.12.2021-za-objava-pdf>

ka rol këshillues dhe mbikëqyrës në zbatimin e politikave dhe aktiviteteve rinore për të rinjtë.⁵ Trupi Këshillëdhënës përbëhet nga nëntë përfaqësues rinor të zgjedhur nga Asambleja Kombëtare Rinore dhe tetë përfaqësues të emëruar nga organet e administratës shtetërore. Me të kryeson një prej përfaqësuesve të sektorit rinor.

Meqenëse Asambleja Kombëtare Rinore nuk është formuar ende, nuk është formuar as Trupi Kombëtar Këshillues për Politikën Rinore, anëtarët e të cilit zgjidhen nga Asambleja Kombëtare Rinore.

Po ashtu, Qeveria përcaktoi institucionet që do të marrin pjesë në këtë organ, gjegjësisht mori vendim dhe ngarkoi Agjencinë për Rini dhe Sport, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Financave të emërojnë përfaqësues në Trupin Kombëtar Këshillues për Politika Rinore.⁶

KËSHILLA RINORE LOKALE

Këshillat rinorë lokalë janë organe të vetëqeverisjes lokale të përbëra nga përfaqësues të rinj të formave të ndryshme të organizimit në Komunë, të cilët kanë rol këshillues dhe avokues për çështjet me interes të të rinjve në vetëqeverisjen lokale. Këshillat rinorë lokalë kanë rol të garantojnë pjesëmarrjen e të rinjve në nivel lokal, përkatësisht në nivel të komunës. Vetë Ligji parashikon krijimin e një këshilli rinor lokal në të gjitha 81 komunat. Këshilli rinor lokal mund të fillojë me formim pas harmonizimit, përkatësisht ndryshimit ose plotësimit të Statutit të komunës që formon organin, me qëllim të përcaktohen formimi i këshillit rinor lokal, përbërja, mandati, si dhe detyrimet dhe përgjegjësitë.⁷ Pas harmonizimit të Statutit, Komuna shpall Thirrje për themelimin e Bordit Iniciativ, i cili përbëhet nga format e organizimit të të rinjve të njohura me Ligj që janë aktive në komunë. Bordi iniciativ shpall thirrjen për konstituimin e Asamblesë lokale për të rinj në përputhje me Statutin e komunave, dhe pas mbajtjes së Statutin e komunave, dhe pas mbajtjes së seancës së parë konstituive të asamblesë lokale rinore, Bordi iniciativ shpërndahet. Asambleja lokale rinore shpall thirrje publike për anëtarët e këshillit rinor lokal, që

5. Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore ("Gazeta zyrtare e RMV", nr. 10/2020)

6. Njoftimi nga seanca e 86-të e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (e qasshme në: <https://vlada.mk/node/25846>)

7. Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Shkup dhe Agjencinë për Rini dhe Sport, "Doracak për Këshillat Rinor Lokal" (e disponueshme në: <https://www.osce.org/files/f/documents/a/c/491135.pdf>)

rinore shpall thirrje publike për anëtarët e këshillit rinor lokal, që është e qasshme për publikun në faqet e internetit të komunës. Asambleja rinore zgjedh anëtarët e këshillit rinor lokal me zgjedhje të drejtpërdrejta me votim të fshehtë, në të cilin të drejtë vote kanë delegatët e asamblesë rinore lokale. Anëtarët e zgjedhur të këshillave rinore lokalë verifikohen nga Këshillat e komunave. Procedura e përcaktuar në këtë mënyrë në Ligj është më e zbatueshme kur bëhet fjalë për krijimin e një këshilli rinor lokal për herë të parë, por në disa komuna ekziston mundësia që një këshill lokal rinor të ekzistojë ose ka ekzistuar, kështu që në një situatë të tillë këshilli duhet të transformohet në mënyrë që të jetë në përputhje me dispozitat ligjore. Për mbështetje shtesë për komunat dhe të rinjtë në nivel lokal, veçanërisht në drejtim të ndërmarrjes së hapave të nevojshëm për themelimin e këshillave rinore lokale, Agjencia për Rini dhe Sport dhe Misioni i OSBE-së, në Shkup kanë hartuar "Manual për këshillat rinorë lokalë".

Nga aspekti i zbatimit të Ligjit për themelimin e këshillave rinore lokale, vetëm në 10 komuna, gjegjësisht vetëm 12% e komunave kanë themeluar Këshillin Rinor Lokal në përputhje me dispozitat e Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politika rinore. Në rastin konkret, në bazë të përgjigjeve të marra nga komunat, bëhet fjalë për Vallandovën, Dellçevën, Kisella Vodën, Kratovën, Mogillën, Novacin, Ohrin, Pllasnicën, Shën Nikollën dhe Strumicën. Disa nga komunat që janë përgjigjur pozitivisht, janë përgjigjur gjithashtu se nuk kanë pasur thirrje publike, gjë që është në kundërshtim me hapat për themelimin e Këshillit Rinor Lokal sipas ligjit.


Është formuar KRL në komunë në bazë të LPRPR

Në process është formimi i KRL

Ekziston KRL para miratimit të LPRPR

Nuk është formuar KRL në Komunë

Nuk ka përgjigje



POLITIKA PËR TË RINJTË

Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore, përveç pjesëmarrjes rinore, rregullon politikat rinore në nivel kombëtar dhe lokal. Në bazë të dispozitave të Ligjit, në nivel kombëtar, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka për obligim që të krijojë dhe miratojë Strategjinë Kombëtare për të rinjtë, për një periudhë pesëvjeçare, e cila përfshin Planin e Veprimit për zbatim. Në nivel lokal, komunat kanë detyrimin të miratojnë strategji lokale për të rinjtë për një periudhë pesëvjeçare, së bashku me Planet e Veprimit për zbatim.

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR TË RINJTË

Strategjia Kombëtare për të Rinjtë është një dokument strategjik që përcakton synimet dhe prioritetet afatmesme për zhvillimin e politikave rinore dhe promovimin e interesave të të rinjve dhe përcakton masat organizative, financiare dhe administrative për arritjen e tyre.⁸

Aktualisht është në fuqi Strategjia Kombëtare për të Rinjtë e Republikës së Maqedonisë së Veriut (2016 - 2025), e cila mbulon këto fusha tematike: pjesëmarrjen rinore, informimin rinor, punën lokale rinore, arsimin, punësimin dhe mbështetjen para punësimit, kulturën, sportin, shëndetin dhe cilësinë e jetës.⁹

Përkundër ekzistimit të kësaj Strategjie Kombëtare, në përputhje me Ligjin e ri për pjesëmarrjen rinore dhe politika rinore, është paraparë të miratohet një strategji e re kombëtare për të rinjtë, konkretisht brenda 18 muajve nga miratimi i ligjit.

Bazuar në informacionet e Agjencisë për Rini dhe Sport, procesi i krijimit të Strategjisë Kombëtare për të Rinjtë, siç kërkohet me Ligjin për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore, do të fillojë në vitin 2022. Afati ligjor për të skadoi më 14 korrik 2021.

Me qëllim të përgatitjes së Strategjisë Kombëtare për të Rinjtë, Agjencia për Rini dhe Sport në nëntor 2021, publikoi shpallje për prokurim publik për kryerjen e hulumtimeve mbi trendet rinore.¹⁰ Gjithashtu, ligji parashikon që Strategjia Kombëtare për të rinjtë të zhvillohet përmes një procesi konsultativ, gjithëpërfshirës dhe transparent dhe që përmbajtja e saj të konsultohet me Trupin Kombëtar Këshillimor për të rinjtë, i cili ende nuk është themeluar.

8. Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore ("Gazeta zyrtare e RMV", nr. 10/2020)

9. Strategjia Kombëtare për Rininë 2016-2025 (e qasshme në: http://ams.gov.mk/images/dokumenti/mladi/National_Youth_Strategy_2016-2025_eng.pdf)


10. <https://e-nabavki.gov.mk/PublicAccess/home.aspx#/dossier/75a6ee24-db90-4828-a159-eeaa28f58bc6/14>

STRATEGJI LOKALE PËR TË RINJTË

Strategjia lokale për të rinjtë është dokument strategjik i cili në përputhje me Strategjinë nacionale për të rinjtë, përcakton synimet dhe prioritetet afatmesme për zhvillimin e politikave rinore dhe promovimin e interesave rinore në nivel vendor dhe përcakton masat organizative, financiare dhe masat administrative për realizimin e tyre.¹¹ Është baza për zhvillimin e politikave lokale rinore të komunës konkrete në pesë vitet për të cilat është miratuar strategjia. Strategjia lokale gjithashtu përmban Plan Veprimi për zbatim me aktivitete të përcaktuara, dinamikë, bartës të aktiviteteve dhe projeksione të mjeteve buxhetore, si dhe kushte dhe indikatorë vlerësimi për zbatimin e Strategjisë Lokale Rinore. Strategjia lokale për të rinjtë, së bashku me planet e veprimit, hartohet nga komunat në bashkëpunim me këshillin rinor lokal, dhe zbatohet me mjete buxhetore nga komuna konkrete.

Sipas të dhënave të marra nga monitorimi i kryer, në 7 komuna janë bërë konsultime me të rinjtë për Strategjinë Lokale Rinore, ndërsa në 11 komuna është miratuar Strategjia Lokale Rinore, përkatësisht vetëm 14% e komunave. Bëhet fjalë për komunat e Bogovinës, Velesit, Gostivarit, Ilindenit, Kërçovës, Koçanit, Kriva Pallankës, Krushevës, Lozovës, Strumicës dhe Çairit.

Sa i përket planeve të veprimit, vetëm 6 komuna janë përgjigjur se kanë hartuar një plan veprimi.



11. Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore ("Gazeta zyrtare e RMV", nr. 10/2020)

**SHËRBIMET
RINORE**

Ligji për pjesëmarrje rinore rregullon edhe shërbimet për të rinjtë që do të mundësojnë afrimin e institucioneve dhe komunave më afër të rinjve, përmes themelimit të zyrave rinore, qendrave rinore dhe emërimit të nëpunësve rinorë.


ZYRA RINORE

Zyrat rinore janë pika kryesore e qasjes për të rinjtë në nivel lokal, dhe prej andej koordinohet puna për të rinjtë nëpër komuna.¹² Nëpunësi i emëruar për rininë në komunë është paraparë të jetë personi përgjegjës për funksionimin e Zyrës rinore.

Zyra rinore në komunë është vendi ku të gjithë të rinjtë nga komuna mund të drejtohen dhe të informohen për çështjet që kanë të bëjnë me rininë ndërkaq janë në kompetencë të komunës.


Sipas ligjit, të gjitha komunat janë të obliguara të themelojnë zyrën rinore jo më vonë se një vit nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikën rinore.

Afati ka skaduar më 14 janar 2021 dhe në pajtim me të dhënat e mbledhura vetëm në 11 komuna (14% e komunave) është themeluar Zyra rinore.



12. Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore ("Gazeta zyrtare e RMV", nr. 10/2020)

Qendrat rinore janë vende ku përgatiten dhe zbatohen programe që përmirësojnë mirëqenien e të rinjve, zhvillimin e jetës personale, sociale dhe profesionale të të rinjve, informacione me interes të rëndësishëm për të rinjtë dhe aspekte të tjera të jetës rinore.¹³ Në pajtim me Ligjin për pjesëmarrjen rinore dhe politikën rinore, secila komunë është e obliguar të themelojë një qendër rinore, brenda 5 viteve nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit. Procedura për hapjen e qendrave rinore dhe sigurimin e cilësisë së tyre është e përcaktuar edhe me Rregulloren për standardet e cilësisë së qendrave rinore¹⁴, i cili u miratua nga Agjencia për Rini dhe Sport dhe u hartua së bashku me Unionin për Punë Rinore.



Deri më tani, sipas përgjigjeve të marra nga komunat, qendra rinore ka në 8 komuna (10% e të gjitha komunave), në këto komuna: Gazi Babë, Gostivar, Kavadar, Kumanovë, Ohër, Sveti Nikollë, Qendër, Çair. Këtu është e rëndësishme të theksohet se vetëm 3 nga komunat e mësipërme i përmbushin standardet e cilësisë së qendrave rinore, të miratuara nga Agjencia për Rini dhe Sport, dhe këto janë komunat e Kavadarit, Kumanovës dhe Ohrit. Qendrat rinore në komunat tjera janë hapur me mbështetjen e donatorëve dhe funksionojnë para miratimit të Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikën rinore.

13. Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore ("Gazeta zyrtare e RMV", nr. 10/2020)


14. Rregullorja për standardet e cilësisë së qendrave rinore, e miratuar nga Agjencia për Rini dhe Sport, (e qasshme në: <https://smr.org.mk/wp-content/uploads/2020/04/Standardi.pdf>)

Gjithashtu, procesi për hapjen e qendrës rinore ka filluar edhe në komunat Manastir, Veles, Vinicë, Probishtip, Shtip. Një nga problemet që paraqitet në Ligj është ndarja e kompetencave të aktorëve të ndryshëm në nivel kombëtar dhe lokal. Përkundër faktit se Agjencia për Rini dhe Sport i ka miratuar standardet e cilësisë së qendrave rinore, ajo nuk ka kompetencë ndaj Komunës e cila ka detyrimin për hapjen e qendrës rinore. **Afati për këtë detyrim ligjor ende nuk ka skaduar.**

NËPUNËSIT RINOR

Në pajtim me Ligjin, të gjitha komunat gjithashtu kanë obligim që të caktojnë nëpunës për të rinjtë, përkatësisht një person i cili do të jetë përgjegjës për punën e Zyrës për të rinjtë, si dhe për koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e çështjeve me interes për të rinjtë në kuadër të kompetencave të institucionit.¹⁵ Nëpunësit e emëruar për të rinjtë janë të qasshëm në faqen zyrtare të Agjencisë për Rini dhe Sport, së bashku me e-maillet e tyre, ku të të rinjtë mund t'i kontaktojnë. Në bazë të listës së publikuar, institucionet dhe komunat kanë shfaqur interesimin më të madh për zbatimin e këtij obligimi, i cili para së gjithash konsiston në emërimin e një personi tashmë të punësuar brenda institucionit, përkatësisht komunës.

Nga informacionet e disponueshme publikisht për nëpunësit e të rinjve¹⁶, mund të konstatohet se deri më tani janë emëruar 53 nëpunës rinor në institucionet shtetërore, përkatësisht organet e administratës shtetërore dhe 56 në komuna. Në përqindje, vetëm 69% e komunave kanë përmbushur të njëjtin detyrim.



15. Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore ("Gazeta zyrtare e RMV", nr. 10/2020)

16. Nëpunësit rinor në Institucione dhe komuna (botuar në Nëntor 2021), në dispozicion në: <http://ams.gov.mk/wp-content/uploads/2021/11/Службеници-за-млади-инственции-и-општни-АМС-ВЛАДА.pdf>

Këto të dhëna tregojnë për vështirësi në zbatimin e ligjit në nivel lokal, gjë që është evidente nga zbatimi i përgjithshëm i ngadalshëm dhe i vonuar i shërbimeve për të rinjtë në komunat.

Ajo që mund të konstatohet në mënyrë plotësuese është se në periudhën pasi lista e nëpunësve për të rinjtë filloi të shpërndahej në faqen e Agjencisë për Rini dhe Sport, pas disa muajsh ka një ndryshim të personave të emëruar.

Prandaj është i nevojshëm profesionalizimi i nëpunësve për të rinjtë në mënyrë që të njihen konkretisht me kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre dhe të sigurohet qëndrueshmëria e kësaj pozite dhe jo rotacioni i saj ndërmjet punonjësve në institucion, përkatësisht komunë. Gjithashtu, për publikun mbeten të panjohura kriteret për emërimin e nëpunësit për të rinjtë, përkatësisht sa dhe nëse personi i emëruar ka njohuri apo përvojë në fushën e politikave rinore dhe punës me të rinjtë.

Afati për zbatimin e këtij detyrimi ligjor skadon brenda një viti nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikën rinore dhe skadon më 14 janar 2021 ndërsa në pajtim me të dhënat e mbledhura, detyrimi nuk është zbatuar plotësisht.

QENDRA KËRKIMORE NË LIDHJE ME TEMA QË KANË TË BËJNË ME TË RINJTË NË AGJENCINË PËR RINI DHE SPORT

Në lidhje me krijimin e politikave përkatëse për të rinjtë, Ligji parasheh që Agjencia për Rini dhe Sport të krijojë një qendër kërkimore për tema të ndryshme që lidhen me të rinjtë.¹⁷ Afati i përcaktuar me ligj për themelimin e qendrës hulumtuese skadon një vit pas hyrjes në fuqi të Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikën rinore, gjegjësisht 14 janar 2021.

Afati ka skaduar ndërsa në Agjencinë për Rini dhe Sport nuk është themeluar qendër kërkimore për tema që kanë të bëjnë me të rinjtë.. Nga aty sqarojnë se aktualisht bëhet ndryshim i sistematizimit të Agjencisë për Rini dhe Sport dhe priten pëlqimet e nevojshme nga institucionet tjera para themelimit të qendrës kërkimore, e cila do të jetë në kuadër të Sektorit të rinjtë në kuadër të Agjencisë.

17. Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore ("Gazeta zyrtare e RMV", nr. 10/2020)

29 FINANCIMI

Ligji për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore përcakton se për zbatimin e këtij ligji nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut ndahen mjete në lartësi prej të paktën 0,3% në vit.¹⁸ Gjithashtu, nga buxhetet e komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit për të rinjtë, ndahen mjete në vlerë prej së paku 0,1% në vit.

Në kuadër të hulumtimit iu drejtuam Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, por pyetja për lartësinë e mjeteve të ndara për të rinjtë u transferua në Agjencinë për Rini dhe Sport. Për këtë, Agjencia për Rini dhe Sport u përgjigj se nuk kanë informacione se sa është buxheti i ndarë për të rinjtë në nivel shtetëror, pasi në institucionet tjera shtetërore mjetet për të rinjtë nuk ndahen në zëra të veçantë.

Pra, mund të konstatojmë se në vetë Ligjin ka paqartësi se cila përgjegjësi i takon cilit aktor dhe kjo në vetvete kontribuon në zvarritjen e zbatimit ose moszbatimit të ligjit.

Për sa i përket financimit në nivel lokal, Komunat kanë detyrimin që të ndajnë së paku 0,1% të buxhetit komunal në baza vjetore. Në bazë të pyetësorit të dorëzuar në komuna, 29 komuna janë përgjigjur se kanë ndarë shumën e deklaruar. Pavarësisht përgjigjes së tillë, nuk ka asnjë mekanizëm që mund ta verifikojë këtë, nëse nuk ekziston një zë i veçantë buxhetor për të rinjtë. Në praktikë, fondet e alokuara për të rinjtë shpenzohen brenda kategorive të ndryshme buxhetore (arsim, social, sport).

Me qëllim të sigurimit të transparencës dhe llogaridhënies ndaj të rinjve, propozojmë Komunat në kuadër të planifikimit të buxhetit të tyre të krijojnë një zë të veçantë për të rinjtë.

18. Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore ("Gazeta zyrtare e RMV", nr. 10/2020)

**KONKLUZIONEDHE
REKOMANDIME**

- Të rinjtë dhe organizatat rinore nuk janë prioritet i institucioneve shtetërore, duke qenë se 2 vjet pas miratimit të Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore, shumë nga mekanizmat e parashikuara për pjesëmarrje rinore dhe shërbime për të rinjtë ende nuk janë zbatuar;
- Komunat tregojnë interes të vogël për zbatimin e detyrimeve ligjore (13% e komunave kanë krijuar një këshill lokal rinor, zyrë rinore dhe/ose një qendër rinore, me përjashtim të emërimit të nëpunësit rinor (69% komunat kanë nëpunës për të rinjtë);
- Për sa i përket zbatimit të mekanizmave për pjesëmarrje rinore, Asambleja Kombëtare Rinore dhe rrjedhimisht Trupi Kombëtar Këshillimor për Politika Rinore ende nuk janë themeluar ndërsa Këshillat Rinor Lokal ekzistojnë vetëm në 10 komuna (12% e numrit të përgjithshëm të komunave).
- Procesi i miratimit të Strategjisë Kombëtare për të rinjtë, si obligim i Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore, sipas informacioneve të Agjencisë për Rini dhe Sport, do të fillojë në vitin 2022. Afati i përcaktuar ligjërisht për të skadoi më 14 korrik 2021.
- Vetëm në 11 komuna është miratuar Strategjia Lokale për të rinjtë, gjegjësisht vetëm 14% e komunave, ndërsa vetëm 6 komuna kanë përgatitur plan veprimi.
- Afati ka skaduar më 14 janar 2021 dhe në pajtim me të dhënat e mbledhura vetëm në 11 komuna (14% e komunave) është themeluar Zyra rinore.
- Deri më tani, qendra rinore ka në 8 komuna (10% e të gjitha komunave). Vetëm 3 nga komunat i përmbushin standardet e cilësisë së qendrave rinore, të miratuara nga Agjencia për Rini dhe Sport, përkatësisht Kavadari, Kumanova dhe Ohri.

- Nga informacionet e disponueshme publikisht për nëpunësit e të rinjve, mund të konstatohet se deri më tani janë emëruar 53 nëpunës rinor në institucionet shtetërore, përkatësisht organet e administratës shtetërore dhe 56 në komuna. Në përqindje, vetëm 69% e komunave kanë përmbushur të njëjtin detyrim.
- Afati ka skaduar ndërsa në Agjencinë për Rini dhe Sport nuk është themeluar qendër kërkimore për tema që kanë të bëjnë me të rinjtë.
- Në vetë Ligj ka paqartësi se cila kompetencë i takon cilit aktor dhe kjo në vetvete kontribuon në zbatimin e vonuar, zbatimin joadekuat ose moszbatimin e disa dispozitave të ligjit.

- Zbatimi urgjent i dispozitave në Ligjin për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikat rinore, veçanërisht në nivel komunal;
- Thirrja dhe mbajtja e seancës mbikëqyrëse për zbatimin e Ligjit për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Krijimi i mekanizmave për monitorimin e zbatimit të Ligjit në nivel qendror dhe komunal;
- Profesionalizimi i nëpunësve për të rinjtë në mënyrë që të njihen konkretisht me kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre dhe të sigurohet qëndrueshmëria e kësaj pozite dhe jo rotacioni i saj ndërmjet punonjësve në institucion, përkatësisht komunë.
- Krijimi dhe zbatimi i programeve për ngritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të Këshillave Rinorë lokalë dhe nëpunës rinorë.
- Krijimi i manualeve për procedurat administrative për krijimin dhe menaxhimin e mekanizmave dhe shërbimeve në kompetencë të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale.
- Hapja e debateve publike për ndryshimin e Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore dhe për avancimin e tekstit ligjor, bazuar në mësimet e nxjerra nga dy vitet e fundit.
- Vendosja e një zëri të posaçëm buxhetor për të rinjtë në buxhetet e komunave dhe institucioneve shtetërore, me qëllim që të jenë transparente dhe të përgjegjshëm ndaj të rinjve për mënyrën se si shpenzohen dhe nëse ndahen realisht mjetet e përcaktuara në ligj.

SHTOJCAT

39 | PYETJE TË CILAT I DËRGUAN NË KOMUNAT

1. A është formuar Këshilli Rinor Lokal në Komunë? Nëse po, sa anëtarë ka këshilli?
2. Vallë ka (pasur) thirrje për anëtarë? Nëse po, a është bërë thirrja publike? A është publikuar në faqen e komunës? Kur u publikua thirrja? (data dhe kohëzgjatja e saktë e aplikimit)
3. Nga çfarë forme organizimi rinor vijnë anëtarët e Këshillit Rinor? (rinore, organizata rinore, studentore, forume rinore të partive politike, etj.)
4. A janë zhvilluar konsultime për Strategjinë Lokale Rinore? A është miratuar strategjia dhe a janë bërë plane veprimi për të?
5. A është formuar zyrë rinore në Komunën e Kisella Vodës? Nëse po, kur është formuar? (data, vendimi?)
6. A është formuar Qendra rinore në përbërje të Komunës? Shënoni vendimin. Nëse po, a janë krijuar programe (në komunat ku janë themeluar)?
7. A është emëruar nëpunës për të rinj në komunë? Nëse po, kur janë emëruar? (data, vendimi?) Nëse komuna ka nëpunës të emëruar, jepni informacionin e tij të kontaktit.
8. Sa është buxheti i ndarë për të rinjtë në komunë (numri i saktë +% i buxhetit). A është kjo përqindje 0,1%?
9. A është ky buxhet për të rinjtë apo është buxhet brenda kategorive të ndryshme buxhetore (arsim, social, sport...)?

PYETJE TË DËRGUARA PËR AGJENCINË PËR RINI DHE SPORT

40

1. Sa organizata rinore, organizata për të rinjtë dhe organizata ombrellë janë të regjistruara në Regjistrin e formave të organizimit rinor?
2. Sa organizata kanë aplikuar për regjistrim në Regjistrin dhe sa aplikacione janë pranuar me sukses?
3. A është formuar Asambleja Kombëtare Rinore? Nëse po, a është miratuar Rregullorja për punën e Asamblesë? Vallë janë zgjedhur përfaqësues në organin këshillues?
4. A ka themeluar Agjencia për Rini dhe Sport, Qendër Kërkimore? (kur - data / vendimi?) Nëse po, kush e përbën Qendrën Kërkimore (të punësuar apo persona të jashtëm)? Si rregullohet puna e kësaj Qendre?
5. A janë zhvilluar konsultime për Strategjinë Lokale Rinore? A është miratuar strategjia? A janë bërë plane veprimi për Strategjinë Kombëtare për të rinjtë?
6. Sa është buxheti i akorduar për të rinjtë në nivel kombëtar? (shifra e saktë +% e buxhetit) Nëse kjo përqindje është 0,3%?
7. A është ky buxhet për të rinjtë apo është buxhet brenda kategorive të ndryshme buxhetore (arsim, social, sport...)?

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје
342.571-053.6:005.584.1(497.7)(047.31)

KULAKOV, Filip

Raport monitorimi për zbatimin e Ligjit për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore / [autor Filip Kulakov ; përkthim nga gjuha maqedonase Vjosa Taipi]. - Shkup : Këshilli rinor nacional i Maqedonisë, 2022. - 40 стр. : граф. прикази ; 21 см

Превод на делото: Мониторинг извештај за имплементацијата на Законот за младинско учество и младински политики. - Фусноти кон текстот. - Содржи и: Shtojcat

ISBN 978-608-66848-1-5

а) Законот за младинско учество и младински политики -- Имплементација
-- Мониторинг -- Македонија

COBISS.MK-ID 56807173

